

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“DIGITAL ALBANIA AGENCY ” SH.P.K

Sot me datë 23.10.2024, bazuar në vullnetin e lirë dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, personi i poshtëshënuar:

1. **Maria XEGA**, e bija e Aleks-it, lindur me datë 15.04.1988, e lindur në Korçë, dhe banuese në adresën Rruga e Mitrollarët, Korçë, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e dokumentit të identifikimit me I85415121D, lëshuar nga Republika e Shqipërisë.

Që në vijim do të quhet "Ortak i vetëm", vendosi të themelojë shoqërinë "DIGITAL ALBANIA AGENCY" SH.P.K (që më poshtë do të referohet si "Shoqëria") dhe të hartojnë Statutin e shoqërisë, sipas përcaktimeve si më poshtë.

Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë QKB sipas parashikimeve të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Neni 1

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

1.1 Shoqëria ka si objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një kompani me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë në përputhje me legjislacionin e Shqipërisë, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë por pa u kufizuar në :

“ Ofrimi i shërbimeve të këshillimit në fushën e teknologjisë, përfshirë këshillime për transformimin digjital, zhvillimin e IT-së, dhe zgjidhje inovative për organizata publike dhe private.

- Krijimi dhe zhvillimi i partneriteteve me ministri dhe institucione qeveritare, për të promovuar zhvillimin teknologjik në vend.
- Mbështetja dhe zhvillimi i ekosistemit teknologjik në Shqipëri, përmes trajnimeve, aktiviteteve të mentorimit dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare.
- Ofrimi i programeve trajnimi dhe zhvillimi për aftësi teknologjike të qëndrueshme dhe në rritje.
- Promovimi i zgjidhjeve digjitale të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.
- Shërbime konsulence dhe trajnime profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit, Softëare dhe hardëare.
- Këshillim, studim, trajnim në fushën e teknologjisë dixhitale.
- Veprimtari në fushën e teknologjisë së informacionit, analize, projektim, programim, testim dhe trajnim programesh aplikative, manaxhim projektsh.
- Këshillim të klienteve të firmës për manaxhim marketingu, biznesi global apo projektsh të ndryshme.
- Konsulence Globale Financiare, Manaxhim të riskut global.
- Shërbime të këshillimit Financiar dhe pajtuesmerise globale të Prokurimit.
- Si edhe çdo veprimtari tjetër tregtare, e lejueshme nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.”

Neni 2

Emërtimi dhe Selia e Shoqërisë

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është "DIGITAL ALBANIA AGENCY" SH.P.K, i ndjekur në mënyrë të pandashme nga shtojca "SH.P.K", që përfaqëson formën juridike të saj.
- 2.2 Selia e Shoqëri së ndodhet në adresën: Korçë, Rruga Korçë-Dishnicë km 1, Zona kadastrale 1101, nr. Pasurisë 221/7, Korçë 7000, Shqipëri.
- 2.3 Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi, degë dhe angjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3

Regjimi juridik

- 3.1 Shoqëria është person juridik shqiptar, ka formën ligjore të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndyshuar.
- 3.2 Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të këtij Statuti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 3.3 Me vendim të saj, Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast, Ortakët duhet të përshtatin Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjnë regjistrimin e tij në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.
- 3.4 Shoqëria gëzon personalitetin juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve

- 4.1 Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje, të nënshkruajë kontrata në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 4.2 Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3 Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak ose aksionar në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4 Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj të nënshkruar dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve dhe as këta të fundit nuk mbajnë përgjegjësi personale për detyrimet që merr përsipër shoqëria.
- 4.5 Ortakët marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Statutin, dhe legjislacionin në fuqi vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.
- 4.6 Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Shoqërisë. Për këtë gëzon të drejtën që të caktojë një person të emëruar prej tij që të marrë këtë informacion.
- 4.7 Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një kohë të pa përcaktuar.

Neni 6
Kapitali i shoqërisë

6.1 Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 168,000 Lekë, (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë lekë).

6.2 Kapitali i regjistruar është plotësisht i nënshkruar dhe i ndarë në 1 kuotë, të zotëruar nga ortaku i vetëm:

1. **Maria XEGA**, e bija e Aleks-it, lindur me datë 15.04.1988, mbajtese e dokumentit të identifikimit me I85415121D, lëshuar nga Republika e Shqipërisë.

6.3 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

6.4 Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

6.5 Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

7.1 Kapitali i shoqërisë mund të Zmadhohet ose të zvogëlohet në çdo moment me vendim të asambleja e përgjithshme e ortakeve, në përputhje me dispozitat e nr.9901 ligjit 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

7.2 Në çdo rast, kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

8.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

8.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

8.3 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit, regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

8.4 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 9

Drejtimi dhe Organet Kryesore

9.1 Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj.

9.2 Emërtimi i Shoqërisë Tregtare, kapitali themeltar, duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentet që nxjerr kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve.

9.3 Organet kryesore të Shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve;
- Administratori.

Neni 10

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë

- 10.1 Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe vendimet e saj janë të detyrueshme.
- 10.2 Të drejtën e thirrjes së Asamblese e kanë Administratori ose ortakët të cilët zotërojnë të paktën 5 % e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 10.3 Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Asamblese së Ortakëve bëhet me letër rekomande të paktën 7 ditë përpara datës së mbledhjes, duke parashtruar rendin e ditës dhe dokumentacionin që do të shqyrtohet.
- 10.4 Mbledhja e Asamblesë thirret detyrimisht një herë në vit dhe jo me vonë se fundi i 6-mujorit të parë.

Neni 11

Përfaqësimi në asamble

- 11.1 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 11.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 11.3 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

- 12.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
- 12.2 Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
- 12.3 Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 12.4 Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 12.5 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrimet e Asambleja së Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullavë procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 14
Administrimi

14.1 Administrator i shoqërisë emërohet në këtë detyrë për një afat 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë. Administrator i parë i shoqërisë është:

1. **Maria XEGA**, e bija e Aleks-it, lindur me datë 15.04.1988, mbajtese e dokumentit të identifikimit me I85415121D, lëshuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 15
Kompetencat

15.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për regjistrimin e biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

15.2 Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve edhe në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

15.3 Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

15.4 Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

15.5 Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 16
Kufizim i kompetencave

16.1 Asambleja mund të vendosë rast pas rasti për kufizimin e kompetencave të administratorit.

Neni 17
Viti Financiar

17.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni 18
Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

18.1 Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 19

19.1 Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 20
Largimi i ortakut

20.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

20.2 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

20.3 Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

20.4 Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mbledhet apo nuk e njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

20.5 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

20.6 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidarë, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Neni 21
Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

21.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;

21.2 Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit

të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtësën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

21.3 Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

21.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Ortakëve .

21.5 Nëse Asambleja e Ortakëve nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 22

22.1 Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

22.2 Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata vepronë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

22.3 Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

22.4 Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së Asamblesë së Ortakëve dhe administratorit.

Neni 23

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

23.1 Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

23.2 Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

23.3 Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

23.4 Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

23.5 Bilancet miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 24

Përfundimi i likuidimit

24.1 Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.

Neni 25

Baza Ligjore

25.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

25.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", i ndryshuar Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 26

Mosmarrëveshjet

26.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti ndërmjet organeve të shoqërisë, ortakëve, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 27

Dispozita perfundimtare

27.1 Ky Statut u redaktua në 2 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë nga ortaku themelues.

ORTAKËT

Maria XEGA

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Maria Xega', is written over the printed name. The signature is stylized and somewhat cursive.